

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	16 protestues në pranga pas protestës së djeshme, Policia del me reagim zyrtar: Dy prej tyre shfrytëzua n momentin për të shitur drogë
ADRESA	https://newsbomb.al/aktualitet/16-protestues-ne-pranga-pas-protestes-se-djeshme-policia-del-me-reagi-i400868
BURIMI	newsbomb.al
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	10 shtator 2026, 10:03:43 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	10 shtator 2026, 09:57:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	a3b5f96ea2e9b2daf656146d52f2671d8e2abe8db6a1f85c9c2144b695ddeb03
TEKSTI	1ce90e8fef07932d16b3207884187c8468543e50f8816143205342113245de97
PAMJA	c203a6c1e88e41b017c10c16c39c1666577087693509f8dc18309335a55e2eb8

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	a76920523b7a9cf23c774d380fcf7c4924302c1a5b9bddaed6814c22c6100c3a
E MËPARSHMJA	5ca3116f46f9a73b3186a0ac23b97b0362c23cd21969ce0e844affccd6f5f4d5
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/a76920523b7a9cf23c774d380fcf7c4924302c1a5b9bddaed6814c22c6100c3a

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored · dritarja 1280×1024 px

Hapësire reklamuese



12 numrat e parë FALAS!

[Version PDF](#)

[Abonohu te Revista](#)



- [Kreu](#)
- [Politikë](#)
- [Aktualitet](#)
- [Ekonomi](#)
- [Kulturë & Art](#)
- [Rajon](#)
- [Sport](#)
- [Bota](#)
- [Showbiz](#)
- [SocialBomb](#)



Created and monetized by  mediadesk



Çështjet kryesore

Live Updates

[Arrestohet Ergys Agasi](#)

E Enjte 10:25

Live Updates

["Retreat"-i i qeverisë në Pogradec!](#)

E Hënë 09:32

Live Updates

[SPAK godet grupin e Eldi Dizdarit dhe Dritan Gjijkës](#)

E Martë 14:24

[Aktualitet](#) 10 Shtator 2026, 11:57

16 protestues në pranga pas protestës së djeshme, Policia del me reagim zyrtar: Dy prej tyre shfrytëzuan momentin për të shitur drogë

Shkruar nga Newsbomb



 16 protestues në pranga pas protestës së djeshme, Policia del me Qytetarët në ditën e 102-të të protestës

Policia e Tiranës ka dalë me njoftim zyrtar në lidhje me personat që janë shoqëruar pas tensioneve në protestën e djeshme, ku bëhet me dije se një shtetas është vënë në pranga dhe 15 të tjerë janë proceduar penalisht. Ndërsa bëhet me dije se dy prej tyre janë proceduar penalisht në gjendje të lirë, pasi gjatë tubimit, nga kontrollet fizike u janë gjetur sasi të lëndës së dyshuar narkotike Cannabis Sativa, e cila është sekuestruar me cilësinë e provës materiale.

Ashtu siç raportuam dhe në mëngjes, burime nga grupi hetimor bëjnë me dije se në pranga është venën shtetasi E. Q., 33 vjeç i cili akuzohet për për veprat penale “Shkatërrimi i pronës”, “Kundërshtimi i punonjësit të policisë së rendit publik”, “Organizimi dhe pjesëmarrja në grumbullime e manifestime të paligjshme” dhe “Prishja e qetësisë publike” si dhe për prishjen e automjetit të një qytetari. Moment i cili është dënuar dhe nga kryeministri Edi Rama.



[Bllokuan kryqëzimet në Tiranë dhe u përplasen me qytetarët, në pranga 15 protestues, tre prej tyre kapen me drogë në xhep \(DETAJE\)](#)

10 Shtator, 10:03

Ndërsa bëhet me dije se janë proceduar penalisht 15 shtetas të cilët gjatë marshimit të 102-të nëpër Tiranë, zgjodhën që të bllokoni qarkullimin e makinave duke u ulur këmbëkryq në kryqëzimet e Tiranës, që shkaktoi dhe pezullimin të lëvizjes së mjeteve dhe tensione mes shoferëve dhe protestuesve.

Konkretisht bëhet me dije se kanë nisur procedimet penale në gjendje të lirë për shtetasit Sh. B., I. M., V. D., A. Rr., S. E., A. P., A. D., E. K., B. K., E. N., A. A., K. Gj. dhe H. T., për veprat penale “Kundërshtimi i punonjësit të policisë së rendit publik”, “Organizimi dhe pjesëmarrja në grumbullime e manifestime të paligjshme” dhe “Prishja e qetësisë publike”.

Këta shtetas janë vendosur në disa prej kryqëzimeve kryesore të qytetit, duke bllokuar qarkullimin dhe pengimin e lëvizjes së lirë të automjeteve dhe qytetarëve, përgjatë Rrugës së Elbasanit, te Kryqëzimi i Urës së Drejtorisë së Policisë Tiranë, te Kryqëzimi i Urës së Vasil Shantos, te Kryqëzimi te 21 Dhjetori dhe te Kryqëzimi te Inxhinieria e Ndërtimit.

Po ashtu, bëhet me dije se për dy të rinjtë me inicialet A. Zh. dhe M. R., kanë nisur procedimet penale në gjendje të lirë pasi dyshja në fjalë akuzohet për të njëjtat vepra penale si të sipërpërmendurit si dhe për “Prodhim dhe shitje të narkotikëve”. Kjo pasi gjatë kontrolleve fizike të kryera nga blutë e Tiranës, dyshes në fjalë u janë gjetur sasi të lëndës së dyshuar narkotike Cannabis Sativa.

Njoftimi i Plotë i Policisë:

Tiranë/Arrestohet 1 shtetas dhe procedohen penalisht 15, për veprime të kundërligjshme gjatë një tubimi të zhvilluar dje.

Në vijim të veprimeve hetimore dhe procedurale të kryera nga shërbimet e Komisarariatit të Policisë Nr. 1 dhe të drejtuara nga Prokuroria, për identifikimin dhe nxjerrjen përpara përgjegjësisë penale të shtetasve të përfshirë në veprime të kundërligjshme, gjatë një tubimi të zhvilluar më datë 09.09.2026, në Tiranë, u bë arrestimi në flagrancë i shtetasit:

E. Q., 33 vjeç, për veprat penale “Shkatërrimi i pronës”, “Kundërshtimi i punonjësit të policisë së rendit publik”, “Organizimi dhe pjesëmarrja në grumbullime e manifestime të paligjshme” dhe “Prishja e qetësisë publike”, pasi dyshohet se ka dhunuar disa kalimtarë gjatë tubimit, si dhe ka dëmtuar automjetin e një qytetari;

Si dhe u referuan materialet në Prokurori, ku nisi procedimi penal në gjendje të lirë për shtetasit Sh. B., I. M., V. D., A. Rr., S. E., A. P., A. D., E. K., B. K., E. N., A. A., K. Gj. dhe H. T., për veprat penale “Kundërshtimi i punonjësit të policisë së rendit publik”, “Organizimi dhe pjesëmarrja në grumbullime e manifestime të paligjshme” dhe “Prishja e qetësisë publike”;

Gjithashtu u referuan materialet në Prokurori, ku nisi procedimi penal në gjendje të lirë për shtetasit A. Zh. dhe M. R., për veprat penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, “Kundërshtimi i punonjësit të policisë së rendit publik”, “Organizimi dhe pjesëmarrja në grumbullime e manifestime të paligjshme” dhe “Prishja e qetësisë publike”. Krahas veprimeve të kundërligjshme të dyshuara të kryera nga këta shtetas, gjatë tubimit, nga kontrollet fizike u janë gjetur sasi të lëndës së dyshuar narkotike Cannabis Sativa, e cila është sekuestruar me cilësinë e provës materiale.

Këta shtetas janë vendosur në disa prej kryqëzimeve kryesore të qytetit, duke bllokuar qarkullimin dhe pengimin e lëvizjes së lirë të automjeteve dhe qytetarëve, përgjatë Rrugës së Elbasanit, te Kryqëzimi i Urës së Drejtorisë së Policisë Tiranë, te Kryqëzimi i Urës së Vasil Shantos, te Kryqëzimi te 21 Dhjetori dhe te Kryqëzimi te Inxhinieria e Ndërtimit.

Grupi hetimor vijon punën në drejtimin e Prokurorisë, për dokumentimin e plotë ligjor të veprimeve të kundërligjshme të kryera gjatë tubimit, si dhe për identifikimin dhe nxjerrjen përpara përgjegjësisë të të gjithë shtetasve të përfshirë në to.

Materialet procedurale iu referuan Prokurorisë, për veprime të mëtejshme.

Sondazh

Poll

Lexo gjithashtu

Aktualitet

[Shpërthimi tek “Eida” në Brryl, çfarë DËSHMUAN tre punonjësit e plagosur: Po furnizonim një makinë me gaz kur...](#)

E Enjte 12:22

Aktualitet

[Kontrollet e makinave luksoze “ngjiten” në veri, sekuestrohet “Rolls-Royce” i lezhjanit që jeton në Angli \(PAMJE-DETAJE\)](#)

E Enjte 12:03

Aktualitet

[Bllokimi i pagave të magjistratëve, KALLËZOHET në SPAK ministri Petrit Malaj](#)

E Enjte 11:40

Aktualitet

[Gjyqtarët pa lekë, qytetarët në “hall”, magjistratët bojkotojnë punën, preken Tirana, Durrësi dhe Berati](#)

E Enjte 11:40 Newsbomb

Aktualitet

[Dy zyrtarët e Bashkisë Tropojë u ndaluan pas vdekjes së punonjësit në krye të detyrës, Ndriçim Gjocaj dhe Gëzim Hasanpapaj do të hetohen në gjendje të lirë](#)

E Enjte 11:22

Aktualitet

[Prej tre ditësh pa gjurmë, familjarët e Saxhide Dishës nga Rrogozhina apelojnë për ndihmë: Na ndihmoni ta gjejmë](#)

E Enjte 10:58

Aktualitet

[Ngërçi me pagat, Sokol Sadushi në një mbledhje të jashtëzakonshme i drejtohet shtetit: Nuk jemi kundërshtarët tuaj, nga përplasja jonë s’fiton askush](#)

E Enjte 10:41

Aktualitet

[Pesë ditë në flakë mali i Tërbunit në Pukë, banorët kërkojnë ndërhyrje nga ajri: Është shkruar 60% të sipërfaqes](#)

E Enjte 10:40

Aktualitet

[ARRESTOHET çifti i moshuar në Gjirakare, efektivët u gjejnë dy thasë me hashash të tharë në cep të shtëpisë dhe 270 rrënjë të mbjella](#)

E Enjte 10:23 Newsbomb

Aktualitet

[Tentuan t’i shpëtonin policisë në Korçë, pasagjeri hedh qesen me drogë nga makina dhe shoferi u arratis, përfundon në pranga 31-vjeçari nga Vlora](#)

E Enjte 10:21

Aktualitet

[Anëtarët e grupit Çopja dhunojnë brutalisht drejtorin e Ujësllësit të Elbasanit, kishte pushuar nga puna gruan e personit që do të hiqte qafe gazetarin Saimir Kodra](#)

E Enjte 10:07

Aktualitet

[Bllokuan kryqëzimet në Tiranë dhe u përplasen me qytetarët, në pranga 15 protestues, tre prej tyre kapen me drogë në xhep \(DETAJE\)](#)

E Enjte 10:03 Newsbomb

Aktualitet

[Asnjë lekë për tokat e tyre që shfrytëzohen nga “Bankers”, banorët e Marinzës dhe Belinës i “mësynë” brenda kompanisë: Kanë dy vite që na tallin \(VIDEO\)](#)

E Enjte 09:12 Newsbomb

Aktualitet

[Çmimi i naftës “fluturon” në tregun global, Trump zotohet se do të ulet pasi të fitojë me Iranin, në Shqipëri litri vijon të shitet me 219 lekë](#)

E Enjte 07:56 Newsbomb

Aktualitet

[Kthjellime e vranësira për ditën e sotme, disa zona pritet të përfshihen nga shiu, ja sa gradë do të shënojë termometri](#)

E Enjte 07:16 Newsbomb

Aktualitet

[“Kafshë të droguar!” Bllokimi i rrugëve në Tiranë nga protestuesit, kantautori DENONCON publikisht: Më goditën me kamera në fytyrë \(REAGIMI\)](#)

E Enjte 07:06 Newsbomb

Revista



Abonohu tani dhe lexoje

Lajmet e fundit

Politikë

[Takimi me zyrtaren e lartë amerikane, Gazment Bardhi zbardh bisedën me Nancy VanHorn \(FOTO\)](#)

E Enjte 12:29

Bota

[Trump “hap thesin”: Do dërgoj 5 mijë dollarë për çdo amerikan, nëse fiton Partia Republikane](#)

E Enjte 11:42

[Zbulohet më shumë artikuj >](#)

Hapësire reklamuese

bombvideo

[Shiko video të tjera në Newsbomb Youtube](#)



[18 vjeçari "nuk zë mend", Policia i tregon vendin: Ishte në arrest shtëpie për vjedhje, doli dhe...](#)



["Të ecim me tjetër ritëm", Taulant Balla kërkon bashkëpunim me opozitën për Shqipërinë në BE](#)



[Intervista e Arben Ahmetajt, Bardhi thumbon keq socialistët: Ia jepni vetë informacionet](#)



[Aksident në autostradën Levan-Tepelenë, makinat përplasen "kokë më kokë"](#)



[E pazakontë tek “Mbretëresha Geraldinë”, vjen në jetë në lindje me natyrale djali me peshë 5.1 kg](#)



[Goditet grupi i drogës në Sarandë, 20 persona të prangosur, shpërndanin lëndën narkotike](#)

**op
ed**

OpEd

[Ramë Pagëzimori, Rilindishtja dhe arti i qeverisjes me fjalor](#)

E Diel 16:23 Adri Nurellari

OpEd

[Një moment vendimtar për Shqipërinë](#)

E Martë 13:45

OpEd

[Një dritare mundësie për Tiranën: Pse “Jo”-ja e Islandës ndaj BE-së favorizon integrimin e Shqipërisë](#)

E Diel 18:33

-
-
-
-

Newsbomb është një media online e pavarur. Përpjekja jonë është të sjellim lajme, analiza dhe komente, në shërbim të interesit publik.

Drejtor i Përgjithshëm: Retin Toka
NIPT: L42417011Q

[Abonohu te Revista](#)

Created and monetized by  mediadesk

- [Politikë](#)
- [Aktualitet](#)
- [Ekonomi](#)
- [Kulturë & Art](#)
- [Rajon](#)

- [Sport](#)
- [Bota](#)
- [Teknologji](#)
- [Showbiz](#)
- [SocialBomb](#)

[ME REGJISTRO](#)

- [Kontakt](#)
- [Të drejtat e përdorimit](#)
- [Cookies](#)

Created and monetized by  mediadesk

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.